



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-016

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga A.Sh., nga Gjilani, kundër aktvendimit të Kryetarit të Gjykatës së Apelit, më datë 29.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e A.Sh., e paraqitur kundër kryetarit të Gjykatës së Apelit – V.T..

A r s y e t i m

Në Gjykata Supreme më datë 31 dhjetor 2024 është pranuar ankesa e palës A.Sh., e ushtruar kryetarit të Gjykatës së Apelit – V.T., tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit konform nenit 9 par.1 nënparagrafit 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pala ankuese A.Sh., në ankesën e tij të parashtruar ndaj kryetarit të Gjykatës së Apelit – V. T., ka paraqitur pretendimet e tij se sa i përket lëndës Ac.nr. 8701/23 ka dyshime të arsyeshme se mund të ketë përpjekje sabotuese me qëllim të zvarritjes së zgjidhjes së kësaj lënde, dhe se lidhur me këtë ka kërkuar nga kryetari i gjykatës fillimin e hetimeve dhe inicimin e procedurës disiplinore në lidhje me trajtimin e kësaj lënde.

Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të palës, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka kërkuar nga kryetari V.T., të deklarohet lidhur me këtë rast dhe ka pranuar deklaratën e të njëjtit.

Në deklaratën e tij, kryetari T., ka deklaruar se ankuesi kishte kërkuar nga Gjykata e Apelit informacione lidhur me statusin e lëndës së tij nga zëvendësadministratori i Gjykatës së Apelit, se lënda është pranuar më datë 17.10.2023 dhe se ka marr numrin Ac.nr. 8701/23. Tutje në deklaratën e tij, ka sqaruar se për shkak procesit të riorganizimit dhe rishpërndarjes së lëndëve të vitit 2021, 2022 dhe 2023 në pajtim me Planin e Veprimit të Zgjidhjes së Lëndëve të Vjetra dhe në fokus të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes së Drejtësisë në Gjykatën e Apelit, lënda në fjalë ishte shmangur në shkresat e një lëndës tjetër si pasojë e lëvizjes dhe ricaktimit të 8500 lëndëve, me paraqitjen e ankesës së ankuesit lënda është gjetur dhe pala është informuar lidhur me të. Tutje, kolegji të cilit i është caktuar lënda me SMIL pas njoftimit nga kryetari i Gjykatës lidhur me urgjencën e lëndës, për të njëjtën kolegji ka vendosur në mënyrë meritore me aktvendimin Ac.nr. 8701/23, të datës 16.12.2024. Pra, lënda në fjalë është përfunduar para katër (4) ditëve prej ditës kur para ka paraqitur ankesën e saj në Gjykatën e Apelit, ndaj gjithë administratës së gjykatës. Prandaj, pretendimet e palës për “sabotim” apo “zvarritje” të qëllimshme nuk qëndrojnë.

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesës vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklarata e kryetarit të Gjykatës së Apelit, si dhe shkresave të lëndës, si autoritet kompetent vlerësoj se në rastin konkret nuk ka bazë ligjore për të hapur rast disiplinor ndaj kryetarit të Gjykatës së Apelit, V. T..

Nga analizimi i të gjitha shkresave të lëndës, është vërtetuar se pretendimet e palës janë të pabazuara dhe si të tilla nuk mund të justifikonin inicimin e një procedure disiplinore ndaj kryetarit. Kjo për shkak se, Gjykata e Apelit me datë 16.12.2024 veçse ka vendosur me aktvendimin AC.nr. 8701/23 lidhur me ankesën e parashtruar të paditëses kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan me numër C.nr. 1923/21 të datës 28.08.2023, dhe rrjedhimisht nga kjo rezulton se në rastin konkret nuk ka pasur përpjekje sabotuese me qëllim të zvarritjes së zgjidhjes së kësaj lënde, siç pretendon pala në ankesën e tij.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se veprimet e kryetarit të Gjykatës së Apelit nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkeljet e parapara me këtë Ligj.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës së Apelit,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.